

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më Datë 03.09.2018, lidhet kjo Kontratë Dhurimi ndërmjet Palëve të mëposhtme:

Znj. Miranda Malo, e bija e Haxhiut, lindur më 08.02.1963 në Tiranë dhe banuese po aty, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar përmes Pasaportës me Nr.BJ9192151 dhe Nr. Personal G35208204S

E cila në vijim të kësaj Kontrate do të cilësohen si "Dhuruese"

Dhe

Znj. Perla Malo, e bija e Muhametit dhe Mirandës, lindur më 11.02.2006 në Tiranë dhe banuese po aty, e mitur dhe pa zotësi për të vepruar, identifikuar përmes Pasaportës me Nr.BC1017017 dhe Nr. Personal K65211032J, **përfaqësuar nga e ëma Znj. Miranda Malo, në cilësinë e Përfaqësueses Ligjore.**

E cila në vijim të kësaj Kontrate do të cilësohet si "Pranuese e Dhurimit".

Bazuar në Nenin 73/1/c të Ligjit Nr. 9901 Datë. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Nenin 761 e vijues të Kodit Civil si dhe në nenin 7, Paragrafi 7.2 dhe 7.4 të Statutit të Shoqërisë "Met Invest" Shpk, nënshkruhet kjo Kontratë Dhurimi Kuotash, me kushtet e mëposhtme:

Meqënëse

Dhuruesia është Ortake e Shoqërisë "Met Invest" Shpk, Shoqëri e themeluar më Datë 04.01.2018, me Seli në Adresën Rruga "Lekë Dukagjini", Pallati 11, Kati 2, Tiranë, me Objekt Aktiviteti "ndërtimi, studimi, projektimi dhe supervizimi i punimeve në fushën e ndërtimit etj..."

Dhuruesia zotëron një kuotë e cila përfaqëson 40% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë "Met Invest" Shpk.

Përmes kësaj kontrate, Dhuruesia shpreh vullnetin e saj të plotë, në formën e parashikuar nga ligji, për të dhuruar 20% të Kuotës që ajo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë "Met Invest" Shpk, në favor të Vajzës së saj Perla Malo.



Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhurimi prej Dhurueses në favor të Pranueses së Dhurimit, të 20% të kuotave që Dhuruesia zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë “Met Invest” Shpk.

Neni 3
Momenti i Kalimit të Pronësisë

Pranuesia e Dhurimit bëhet pronare e 20 % të kuotave të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë “Met Invest” Shpk, që në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4
Pasojat Ligjore të Dhurimit

Pranuesia e Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj kontrate, zotëron në Asamblenë e Ortakëve të Shoqërisë “Met Invest” Shpk të drejta vote në përpjestim me përqindjen e kuotës që ajo zotëron në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë.

Pranuesia e Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj kontrate, ka të drejtën e përfitimit të dividendëve nga Shoqëria “Met Invest” Shpk, në raport me përqindjen e kuotës së saj në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë.

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Dhuruesia do të zotëroj një Kuotë e cila do të përfaqësoj 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë “Met Invest” Shpk.

Kjo Kontratë do të depozitohet prej palëve ose Shoqërisë “Met Invest” Shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me qëllim për t’u reflektuar në Ekstraktin për të Dhënat e Subjektit “Met Invest” Shpk, rrethi i ri ortakëve të Shoqërisë dhe pjesët e zotëruara nga secili prej tyre në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë.

Neni 5
Detyrimet e Pranuesit

Pranuesia e Dhurimit përgjigjet në mënyrë solidare me ortakët e tjerë të Shoqërisë për të gjitha detyrimet që rëndojnë mbi Shoqërinë, në përpjestim me pjesën e kuotës që ajo zotëron.

Neni 6
Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

PALËT

DHURUESIA

Miranda MALO

Miranda Malo



PRANUESIA E DHURIMIT

Perla Malo

**Përfaqësuar nga Përfaqësuesja e saj Ligjore
E Ëma**

Miranda MALO

Miranda Malo

